



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
AVOKATI I POPULLIT

Nr. 56/11 Prot.,

Tiranë më, 27/01 /2023

URDHËR

Nr. 10, datë 27.01.2023

PËR

**MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË POZICIONEVE TË PUNËS TË INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT**

Mbështetur në nenin 2 dhe 35 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ligjin nr. 84/2022, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2023", si dhe të nenit 5 dhe 57 të Rregullores së Brendshme të Punës, miratuar me Urdhrin e Avokatit të Popullit nr. 129, datë 17.06.2022,

**URDHËROJ:**


1. Miratimin e strukturës së Institucionit të Avokatit të Popullit, sipas lidhjes nr.1, bashkëlidhur.
2. Miratimin e organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës, sipas lidhjes nr. 2, bashkëlidhur.
3. Urdhri nr. 17, datë 04.02.2022, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës në Institucionin e Avokatit të Popullit", i ndryshuar, shfuqizohet.
4. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtorja e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

AVOKATI I POPULLIT

ERINDA BALLANCA





AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Memo

**Drejtuar:** Znj. Erinda BALLANCA  
Avokati i Popullit

**Përgatiti:** Z. Fatbardh ZENELAJ  
Sekretar i Përgjithshëm

Znj. Renisa Tusha  
Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore

**Datë:** 12 Janar 2023

**Lënda:** Mbi miratimin e strukturës dhe organigramës së re të institucionit të Avokatit të Popullit

*E nderuar znj. Avokate,*

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kombëtar për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, në veprimtarinë e tij duhet të mbështetet nga një infrastrukturë që mundëson realizimin e objektivave dhe qëllimeve të tij, në përputhje të plotë me Parimet e Parisit dhe Parimet e Venecias.

Kjo qasje është nënvizuar në mënyrë të vazhdueshme edhe nga raportet e organizatave ndërkombëtare, në të cilin është theksuar, ndërmjet të tjerash, nevoja për një *qasje gjithëpërfshirëse për të forcuar kapacitetin e Avokatit të Popullit* në trajtimin e rasteve të shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Kjo padyshim do të kërkonte një menaxhim të duhur të burimeve njerëzore përmes një vlerësimi të vazhdueshëm të njësive dhe strukturave të institucionit si një mjet i rëndësishëm dhe strategjik që ndihmon në krijimin e një përparësie të qëndrueshme konkurruese të institucionit dhe i shton

vlerën asaj, si dhe rekrutimit të një trupe punonjësish të mirë përgatitur, profesionale të aftë për t'i shërbyer interesit publik dhe për të qenë të përgjegjshëm për veprimet e ndërmarra në interes të qytetarëve.

Siç jeni në dijeni, mënyra e miratimit të strukturës dhe organikës së institucionit, është parashikuar shprehimisht në nenin 35, paragrafi 3 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar. Në ndryshim nga shumë institucione të pavarura kushtetuese, dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj, struktura dhe organika e institucionit caktohet nga vetë Avokati i Popullit, çka krijon fleksibilitetin e nevojshëm për t'ju përshtatur dhe përgjigjur në formën dhe mënyrë e duhur funksioneve e detyrave të institucionit.

Gjatë viteve të fundit, struktura dhe organika e institucionit ka pësuar ndryshime të herëpashershme, ndryshime që kanë synuar rritjen e efikasitetit dhe përshtatjen me rregullat dhe procedurat e parashikuara nga kuadri ligjor në fuqi në fushën e shërbimit civil. Këto ndryshime kanë synuar dhe reflektuar pasjen e një strukture të qëndrueshme në kohë, relativisht homogjene me strukturat dhe kategorizimet e punonjësve të institucioneve të tjera shtetërore si dhe plotësimin e standardeve në drejtim të formatimit të njësive të strukturës.

Struktura aktuale në fuqi është miratuar me Urdhrin e brendshëm nr. 42, datë 18.02.2020, "Për disa ndryshime në Urdhrin nr. 17, datë 04.02.2022 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës në Institucionin e Avokatit të Popullit", strukturë e cila është amenduar me Urdhrin nr. 17/1 Prot., datë 24.05.2022.

Në kuadër të paraqitjes së kërkesave buxhetore për vitin 2023 dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, por edhe gjatë diskutimeve në Komisionin e Ligjeve, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë, institucioni kërkoi miratimin e disa shtesave në burime njerëzore duke paraqitur dhe argumentet përkatëse.

Me miratimin e ligjit nr. 84/2021, "Për buxhetin e vitit 2023", u konstatua se numri i përgjithshëm i miratuar i punonjësve të institucionit për vitin 2023 është 59 (pesëdhjetë e nëntë) nga 57 (pesëdhjetë e shtatë) që ishte. Këto shtesë kanë të bëjnë me:

*-shtimin e një specialisti në fushën e teknologjisë së informacionit (kategoria III-b), nisur ndër të tjera nga nevoja e mirëmbajtjes së infrastrukturës të teknologjisë të institucionit, gjenerimit dhe përpunimit të statistikave si dhe si dhe nevojës së mbrojtjes nga sulmet kibernetike;*

*- shtimin e një ndihmëskomisioneri, i cili sipas propozimit Tuaj do të jetë pjesë e Seksionit të Përgjithshëm, por përshkrimi i punës për këtë pozicion do të fokusohet kryesisht në çështjet që lidhen me promovimin, informimin apo sensibilizimin lidhur me të drejtat e njeriut si dhe rolin e institucionit në këtë drejtim, bazuar sidomos në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.*

Nisur nga pozicioni i punës, çështjet që do të trajtojnë si dhe kriteret dhe eksperiencia që do të kërkohet për to, vlerësojmë që pagesa për pozicionin e ri të punës "ndihmëskomisioner" duhet të jetë e kategorisë II-b, në përputhje të plotë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit", i ndryshuar.

eps

Këto ndryshime padyshim duhet të reflektohen edhe tek struktura e institucionit, duke respektuar të njëjtat parime dhe standarde që ndiqen gjatë hartimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës shtetërore në përputhje të plotë me vendimin nr. 893, datë 17.12.2014, “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”.

Së dyti, një propozim tjetër që mendojmë që duhet të reflektohet në strukturën e re është dhe përfshirja e pozicionit “Arkivist/Bibliotekarë” brenda marrëdhënieve të shërbimit civil. Aktualisht ky pozicion rregullohet mbi bazën e dispozitave të Kodit të Punës por për vetë rëndësinë dhe specifikën e pozicionin sugjerohet që edhe ky pozicion të jetë tashmë pjesë e marrëdhënieve të punës brenda shërbimit civil.

Ky propozim mbështetet dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e Administratës Shtetërore dhe Institucionet e Pavarura”, i ndryshuar, në të cilin përfshihet edhe pozicioni “Arkivist/Bibliotekarë”, si klasifikim pozicioni pune brenda shërbimit civil për grupet e pozicioneve të administrimit të posaçëm.

Sipas vendimit të mësipërm përshkrimi i përgjithshëm i punës për këtë pozicion lidhet me përgjegjësinë për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe restaurimin e fondit arkivor dokumentar të institucionit, për krijimin e sistemeve të arkivimit të dokumentacionit në përputhje me legjislacionin përkatës për arkivat, përshkrim pune i cili është i njëjtë dhe me atë që operohet aktualisht.

Sa më sipër, me miratimin e këtij propozimi ky pozicion pune do të nënshtrohet rregullave dhe procedurave të rekrutimit në përputhje me legjislacionin në fushën e shërbimit civil duke respektuar standardet përkatëse të përshkrimit dhe kërkesave të vendit të punës. Për shkak të specifikës dhe rëndësisë që lidhet me mirëmbajtjen dhe menaxhimin e tërë fondit arkivor të krijuar në institucion e për të cilën kërkohen njohuri të thella profesionale në fushë, mendojmë që pagesa për këtë pozicion pune duhet të jetë e *kategorisë III-b*.


Së treti, gjykojmë që është e nevojshme që pozicioni i punës “Specialist Protokoll”, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e Administratës Shtetërore dhe Institucionet e Pavarura”, i ndryshuar, të ndryshojë në emërtesën “Specialist Protokoll/Arkivë”.

#### *Efektet financiare*

Shtesat në burimet njerëzore të miratuara me ligjin e buxhetit për vitin 2023 kanë një efekt financiar vjetor prej 3 milion lek dhe nuk janë shoqëruar me akordimin e buxhetit përkatës. Kjo do të thotë që në buxhetin e miratuar për AP për vitin 2023, nuk janë përfshirë fonde buxhetore për të mbuluar kostot që kërkohen për rekrutimin e këtyre punonjësve. Gjithsesi, është dakortësuar me Ministrinë përgjegjëse për financat që këto fonde të akordohen në një moment të dytë. Ndërkohë që për propozimin e pozicionit Arkivist/Bibliotekar brenda marrëdhënieve të shërbimit civil ka një efekt financiar në vlerën prej 460 mijë lek, vlerë e cila është e përballueshme nga fondi i pagave e miratuara për vitin 2023.

Bashkëlidhur kësaj memoje, lutem, do të gjeni strukturën e re të Institucionit si dhe organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës.

LIDHJA NR.1



*Handwritten signature*

Lidhja Nr.2

Emërtimi i funksionit	Numri i Punonjësve (59)	Kategoria/Klasa
Avokati i Popullit	1	Ligji nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar
Kabineti	5	VKM nr. 187, datë 08.03.2017, i ndryshuar
-Drejtor Kabineti	1	I-b
-Këshilltar	3	VKM nr. 187, datë 08.03.2017, i ndryshuar
-Sekretar	1	
- Sekretar i Përgjithshëm	1	I-a
Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre	7	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar
- Komisioner	1	II-a
- Ndihmëskomisioner	3	II-b
- Ndihmëskomisioner	3	
Seksioni për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor	5	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar
- Komisioner	1	II-a
- Ndihmëskomisioner	2	II-b
	2	

- Ndhmëskomisioner		
<b>Seksioni i Përgjithshëm</b>	<b>8</b>	
- Komisioner	1	<b>Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar</b>
- Ndhmëskomisioner	4	II-a
- Ndhmëskomisioner	3	II-b
<b>Seksioni për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve</b>	<b>4</b>	
- Komisioner	1	<b>Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar</b>
- Ndhmëskomisioner	2	II-a
- Ndhmëskomisioner	1	II-b
<b>Mekanizimi për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjëzësor ose poshtëruës</b>	<b>6</b>	
- Komisioner	1	<b>Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar</b>
- Ndhmëskomisioner	2	II-a
- Ndhmëskomisioner	3	II-b
<b>Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve</b>	<b>19</b>	
- Drejtor	1	II-b
<b>Sektori i Burimeve Njerëzore</b>		

- Përgjegjës Sektori	1	III-a
- Specialist për Burimet Njerëzore	1	III-b
- Specialist Protokoll/Arkiv	1	III-b
- Specialist Arkivist/Bibliotekar	1	III-b
<b>Sektori i Shërbimeve</b>		
- Përgjegjës Sektori	1	III-a
- Shofer i titullarit	1	Klasa VI
- Shofer	2	Klasa IV
- Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme	1	Klasa VI
- Punëtor pastrimi	2	Klasa I
<b>Sektori i Financës dhe Prokurimeve</b>		
-Përgjegjës Sektori	1	III-a
-Specialist i Financës	1	III-b
-Specialist i Prokurimeve	1	III-b
<b>Sektori i IT dhe Pritjes së Qytetarëve</b>		
- Përgjegjës sektori	1	III-a
- Specialist IT	1	III-b
- Specialist i Shërbimeve ndaj Qytetarit	2	III-b
<b>- Sektori për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe integrimin evropian</b>		
- Përgjegjës Sektori	1	III-a
- Specialist	2	III-b